

VENDIM
Nr. 220, datë 20.12.2019

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 187, DATË 10.11.2017, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBGAZ” SHA, NË AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR”, TË NDRYSHUAR DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 188, DATË 10.11.2017, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBGAZ” SHA NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 16, pika 12; të neneve 46 dhe 56 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; të nenit 113, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; të neneve 8 dhe 9 të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe të miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror”, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 118/44 prot., datë 16.11.2019, mbi një ndryshim në vendimet e bordit të ERE-s nr. 187 dhe nr. 188, datë 10.11.2017, konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 36, datë 4.3.2019, ka vendosur:

- Të miratojë një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, të ndryshuar, si më poshtë:

“- Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.12.2019, në mbështetje të nenit 24, pika 2, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë gjithë dokumentacionin e munguar ...”.

Dhe, me vendimin nr. 37, datë 4.3.2019, vendosi:

1. Të miratojë një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, të ndryshuar, si më poshtë:

“- Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që, brenda datës 20.12.2019, në mbështetje të nenit 24, pika 2, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë gjithë dokumentacionin e munguar ...”.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 51 prot., datë 17.5.2019, protokolluar në ERE me nr. 266/4 prot., datë 20.5.2019, si dhe shkresës nr. 52 prot., datë 17.5.2019, protokolluar në ERE me nr. 354 prot., datë 20.5.2019, ka bërë me dije ERE-n për mbylljen e procesit të pajisjes me certifikata pronësie dhe ka njoftuar për zmadhimin e kapitalit.

- Në vijim, shoqëria “Albgaz” sh.a. i është drejtuar ERE-s me shkresën nr. 122 prot., datë 2.12.2019, protokolluar në ERE me nr. 196/1 prot., datë 2.12.2019, me anë të së cilës ka kërkuar shtyrjen e afatit të dërgimit të dokumentacionit të munguar deri në datën 20.6.2020, duke u shprehur se pajisja me dokumentet e kërkuara është një proces që kërkon kohë dhe është në varësi të përgjigjes nga institucionet përkatëse.

- Gjithashtu, me qëllim plotësimin e dokumentacionit, shoqëria “Albgaz” sh.a. informon ERE-n se ka aplikuar për transferimin e lejes mjedisore të (tipi A) pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe është ende në pritje.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a. deklaron se ka parashikuar në Programin e Zhvillimit Ekonomik për vitin 2020, pagesën e certifikatës së sigurimit si shoqëri sigurimi.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 51 prot., datë 17.5.2019, protokolluar në ERE me nr. 266/4 prot., datë 20.5.2019, ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- certifikatë pronësie për Sheq i Madh, me numër pasurie 44/6, me datë lëshimi 9.8.2017;
- certifikatë pronësie për Fier, Drizë, me numër pasurie 93, me datë lëshimi 9.11.2017;
- certifikatë pronësie për Fier, Gjonçë, me numër pasurie 267/10, me datë lëshimi 9.11.2017;
- certifikatë pronësie për Lavdan, Mallakastër, me numër pasurie 549, me datë lëshimi 18.12.2017;
- vërtetim dokument hipotekar nga ZRPP-ja përkatëse për Drenovë, Mallakastër, me numër pasurie 1/6, me datë lëshimi 27.4.2018;

- vërtetim dokumenti hipotekar nga ZRPP-ja përkatëse për Balldren, Elbasan, me numër pasurie A, me datë lëshimi 24.7.2018;

- certifikatë pronësie për Cërrik, Elbasan, me numër pasurie 12/289, me datë lëshimi 24.4.2019.

Sa më sipër, rezulton se kushti i vendosur në vendimet e bordit të ERE-s, përkatësisht nr. 187 dhe nr. 188, datë 10.11.2017, që lidhet me dokumentacionin që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka, për të kryer funksionet ose për të plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar, është plotësuar tërësisht nga shoqëria “Albgaz” sh.a.

- Dokumentacioni i cili mbetet për t’u plotësuar në vijim deri në datën 20.6.2019, nga ana e shoqërisë “Albgaz” sh.a. është si më poshtë:

- Pajisja me lejet dhe autorizimet mjedisore (neni 9, pika 1, germa “d”, “vi”) e “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror”.

- Depozitimi në ERE i certifikatës së sigurimit të lëshuar nga shoqëri sigurimi (neni 9, pika 1, germa “e”, “iv”) e “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, si më poshtë:

“Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.6.2020, në mbështetje të nenit 24, pika 2, e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar ...”.

2. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 188, datë 10.11.2017, si më poshtë:

“Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.6.2020, në mbështetje të nenit 24, pika 2, e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar ...”.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti